



URDHËR Nr. 42, datë 11.2.2022

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE TË SHËNIMEVE SHPJEGUESE
TË STANDARDEVE KOMBËTARE TË KONTABILITETIT (SKK)
PËR NJËSITË EKONOMIKE TË VOGLA**

Në mbështetje të nenit 3, pica 4 dhe pica 5, të ligjit nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.7.2019, “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e ndryshimeve të shënimeve shpjeguese të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) për njësitë ekonomike të vogla.
2. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

Delina Ibrahimaj

Botuar ne F.Zyrtare 31/2022

Dale nga shtypi me 25.02.2022